



Bordi i Drejtorëve i K.R.U "RadonIQI" SH.A-Gjakovë, komfor Rregullores së brendshme të kompanisë mbi Marëdhënjen në punë të Punëtorëve" dhe "Rregulloren mbi Organizimin e brendshem dhe sistematizimin e punëve dhe detyrave të punës" e bazuar në Ligjin e Punës në Kosovë Nr. 03L-212 , nxjerr këtë:

## V E N D I M

### MBI LLOGARITJEN E TE ARDHURAVE PERSONALE PËR KATEGORINË E PUNËTORËVE – INKASANT PËR VITIN 2012

#### KREU I.

##### Dispozitat e përgjithshme

##### Neni 1.

Me këtë Rregullore përcaktohet llogaritja e të ardhurave personale, për kategoritë e punëtorëve të Sektorit të shitjes – Inkasant për vitin 2012, për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës sipas përshkrimit me "Rregulloren mbi organizimin e brendshem dhe sistematizimin e punëve dhe detyrave të punës" ( nr.33 aprovuar me dt. 24.05.2010) baza e të ardhurave e cila llogaritet sipas realizimit dhe duke u bazuar në Biznes Planin e vitit 2012.

#### KREU II.

##### Qëllimi i fushveprimit

##### Neni 2.

Qëllimi i kesaj Rregullore është realizimi i objektivave të kompanisë të parapara me Biznes Planin për vitin 2012, si:

- a. Arritja e objektivave të Kompanisë të parapara me Planin e Biznesit të vitit 2012,
- b. Trajtimi i drejtë i punëtorve në kryerjen e punëve dhe detyrave të punës dhe stimulimin e tyre,
- c. Rritja e moralit të punës,
- d. Mbrojtja e të drejtave themelore të punës,
- e. Plotsimi i standardeve minimale të shërbimeve,
- f. Mbrojtja e interesave të kompanisë për të drejtat dhe obligimet e saja,
- g. Sjelljet e drejta në maradhënje e kontakt me konsumatorin,
- h. Mbrojtja e interesave të konsumatorëve për të drejtat dhe obligimet e tyre,
- i. Zvoglimi i sasisë të humbjeve të ujit të pijës,
- j. Eliminimi i keqpërdorimeve eventuale, të shpenzimit të ujit nga konsumatorët
- k. Zvoglimi deri në eliminim i lidhjeve ilegale në rrjetin e ujit të pijës,
- l. Leximi i saktë mujor i ujmatësve të konsumatorët për ujin e pijës të shpenzuar,
- m. Rritja e numrit të konsumatorve që shfrytëzojnë ujin e pijës (konsumatorët e rinjë),
- n. Rritja e sasisë së faturuar të ujit të pijës për konsumatorët, sipas leximit të saktë të ujëmatësve dhe atyre paushall,
- o. Rritja e inkasimit të faturuar për vitin 2012 dhe të borjeve të mbetura të pa paguara nga konsumatorët sipas gjendjes - Salldo 31.12.2011,
- p. Kontrollimi për çdo muaj veç e veç i gjendjes së inkasimit (sasisë dhe përqindjes së inkasimit) dhe marrja e masave për muajt vijues,
- q. Evitimi i keqpërdorimeve eventuale, etj.
- r. Kompenzimi sipas suksesit të arritur në punë,
- s. Etj.

### **KREU III**

#### **Llogaritja e të ardhurave personale – pagës mujore për kategorinë e punëtorëve INKASANT**

##### **Neni 3.**

**Të ardhurat personale - paga mujore për inkasantet ÇAKTOHEN në bazë të kryerjes së punëve dhe detyrave të punës mujore për vitin 2012, si:**

- 1. leximi i ujmatësve të të gjithë konsumatorve për ujin e pijës të shpenzuar që ka në terrenin e tij**
- 2. zbulimin dhe evidentimin si dhe paraqitjen e konsumatorëve paushallistë pa ujmatës të cilet janë kyqur në rrjet dhe shpenzojnë ujin e pijës,**

3. zbulimin dhe evidentimin si dhe paraqitjen e konsumatorve te ri, të cilët janë kyqur në rrjetë pa pelqimin - lejen e Kompanisë dhe shpenzojnë ujin e pijës,
4. shpërndarjen e faturave mujore te konsumatorve për ujin e pijës të shpenzuar,
5. inkasimin e faturave mujore nga konsumatorët për ujin e shpenzuar ( të cilat në vehte përmbajnë shumën mujore të faturës për vitin 2012 dhe borxhin e pa paguar nga konsumatorët deri me Salldo 31.12.2011 ).

#### Neni 4.

Plani i inkasimit mujor – ngarkesa mujore për inkasantet përcaktohet duke u bazuar në Biznes Planin e vitit 2012, e cila përfshinë:

- 4.1. Ngarkesën mujore sipas faturave të konsumatorve për ujin e shpenzuar 100% për çdo muaj të vitit 2012 dhe
- 4.2. Borgjet e pa inkasuara – të pa paguar nga konsumatorët për ujin e shpenzuar me salldo 31.12.2011.

#### Neni 5.

5.1. Të ardhurat personale - Paga mujore për inkasant llogaritet:

5.2. Paga bazë e secilit inkasant në muaj është Kooficienti 5 (pesë).

5.3. Në emer të realizimit te inkasimit të përgjithshëm mujor, inkasantet do të marrin edhe premi bazë mujore - që llogaritet nga shuma e realizimit të Planit të inkasimit mujor – ngarkesës mujor sipas faturave dhe nga shuma e Borxhit të pa inkasuar – të pa paguar nga konsumatorët për ujin e shpenzuar e të pa paguar deri me Salldon 31.12.2011, e cila llogaritet sipas kësaj formule veç e veç:

- a. Për Shumën e Planit të inkasimit mujor – ngarkesës mujore, të realizuar inkasimin mujor prej 100%, inkasantet do të marrin premi bazë mujore prej 10%, e cila llogaritet me këtë formul:

Shuma e realizuar e inkasimit mujor prej 100% /minus/ TVSH-ja /herë / 10% =  
= Premija bazë mujore,

- b. Për Shumën e Planit të inkasimit mujor – ngarkesës mujore, të realizuar inkasimin mujor më pakë se 100%, inkasantet do të marrin premi bazë mujore prej 8%, e cila llogaritet me këtë formul:

Shuma e realizuar e inkasimit mujor më pakë se 100% /minus/ TVSH-ja /herë / 8% =  
= Premija bazë mujore.

- c. **Për ndryshimin e shumës të realizuar inkasimin mujor mbi 100%,** inkasantet do të marrin premi bazë mujore në ndryshimin e shumës prej **15%** e cila llogaritet me këtë formul:

**Ndryshimi i shumës të inkasimit të realizuar mujor mbi 100%/minus/ TVSH-ja /herë/ 15% = Premija bazë mujore.**

- d. Punëtorëve Inaksant ju takon Pushimi i rregullt vjetor sipas Ligjit të Punës Nr. 03/ L-212 si dhe në Rregulloren mbi Marrëdhënje në punë të Punëtorëve.

**5.4. Për realizimin e Planit të inkasimit mujor – ngarkesa mujore sipas faturave të konsumatorve për ujin e pijes të shpenzuar, sipas Nenit 4. inkasantit do bëhet pagesa sipas ketyre shkalleve**

a. Nëse inkasanti realizon inkasimin Planin e inkasimit mujor – ngarkesa mujore sipas Nenit 4. prej **100% -80%** , paga bazë mujore sipas Nenit 5. pikës 5.2. do të ju paguhet 100%.

b. Nëse inkasanti realizon inkasimin Planin e inkasimit mujor – ngarkesa mujore sipas Nenit 4. më pakë se **80% - 70%**, paga bazë mujore sipas Nenit 5. pikes 5.2. do të ju zbritet 30%.

c. Nëse inkasanti realizon inkasimin Planin e inkasimit mujor – ngarkesa mujore sipas Nenit 4. më pakë se **70%** paga bazë mujore sipas Nenit 5. pikes 5.2. do të ju zbritet 50%. si dhe do të fillon procedura disiplinore ndaj tij menjëherë sipas Ligjit të punes, për mos realizim të punëve dhe detyrave të punës dhe do të merret masa përkatëse.

**5.5. Leximi i ujëmatësve nga ana e inkasantve për të gjithë shpenzuesit e ujit – konsumatorët që i ka në zonën e tij, është obligative të bëhet për çdo muaj deri me datën 25. të muajit vijues dhe leximi duhet të bëhet me gjendjen reale të harxhimit e jo duke e zbritur - më pakë, në bazë të të cilit lexim bëhet faturimi i ujit të pijës të shpenzuar për konsumatorin për muajin përkatës dhe inkasimi i faturës duhet të bëhet në tërësi – 100%.**

**5.6. Nëse inkasanti nuk sjellin gjendjen e saktë të lexuar të ujëmatësve të konsumatorve për ujin e shpenzuar deri me datën 25 (njëzetepese) të çdo muaji do të dënohet me 80 Euro në të ardhura personale për atë muaj.**

**5.7. Nëse inkasanti e përseritë edhe një herë tjetër gjatë vitit 2012 mos sjelljen e gjendjes së lexuar të ujmatësve të konsumatorëve deri me 25 (njëzetepese) të ndonjë**

muaji tjetër, do të merrën masat disiplinore ndajë tij sipas Ligjit dhe akteve normative të kompanisë.

5.8. Në bazë të leximit real të ujmatsëve nga ana e inkasantëve, bëhet edhe faturimi mujor real nga kompanija për ujin e pijës të shpenzuar nga konsumatorët, që është bazë për shpërndarjen e tyre te konsumatorët dhe inkasimin e faturës në tërësi - 100% nga ata.

5.9. Inkasantët nuk kanë kufizime për llogaritjen dhe shpërbllim me të ardhura personale – paga mujore, për shumën e realizuar të inkasimit sipas Nenit 5 pikes 5.2. dhe 5.3.

5.10. Pagesat e faturave të bëra nga ana e konsumatorëve me vullnetin e tyre në arkën e kompanisë, të bëra sipas faturës mujore të dërguara nga ana e inkasantëve te konsumatori, i llogariten në realizim të inkasantëve për angazhimin e bërë në zonën – terrenin e tyre.

5.11. Pagesat e faturave të bëra nga ana e konsumatorëve me vullnetin e tyre në arkën e kompanisë, të bëra sipas gjendjës së ujmatsësit që sjellë konsumatori për muajin apo periudhën më të gjatë, për shkak se inkasanti nuk ka shkuar me lexuar ujmatsësin e tij, nuk i llogariten në realizim të inkasantëve për shkak mos kryerjes së punëve dhe detyrave në zonën – terrenin e tyre.

5.12. Pagesat e borxhit të bëra nga konsumatorët sipasë kërkesës me kushtëzim të kërkuara nga ndonjë institucion për sjelljen e vertetimit, bëhen në Arkën e kompanisë, dhe në bazë të dëshmisë për pagesë të borgjit lëshohet vertetimi nga Udhëheqësi për maradhënje me konsumator.

Kjo pagesë nuk hynë në realizimin e inkasanteve për t'ardhura personale – paga mujore.

5.13. Inkasimi i bërë nga ana e konsumatorve për ujin e shpenzuar, nga angazhimi i grupeve të tjera, të caktuara me vendim nga menaxhmenti për shkak të ramjes së inkasimit në zona të caktuara, për këtë shumë nuk do të shpërblehen inkasantët, por grupi që ka realizuar inkasimin i cili shpërbllim do të caktohet sipas ligjit me vendim te menaxhmentit.

5.14. Nëse konstatohet nga ana e kontrollës apo ndonjë ekipi tjetër që formon menaxhmenti me vendim të posaqëm për kontrolla të paplanifikuara te konsumatorët, se është berë **3 (tre) lexime të ujmatsëve të gabuara** gjatë muajit, inkasantit do të i zbritën **10%** e të ardhurave personale mujore (pages bazë + realizimi - TVSH). Nëse bëhen më shumë se **3 (tre)** gabime të leximit të ujmatsëve, atëherë do të merren edhe masa disiplinore ndaj inkasantit sipas ligjit.

**5.15.** Nëse prapë edhe në dy muaj gjatë vitit 2012 konstatohen raste të leximit të gabuar të ujëmatësve, atëherë ndajë inkasantit do të merren masat disiplinore në pajtim me dispozitat Ligjore, deri me largim nga maradhenja e punës.

**5.16.** Në kontratën e punës të jetë e definuar nën detyrat e punës përveç inkasimit të sipas faturave edhe leximi i saktë i ujëmatësve për konsumin e ujit nga konsumatori dhe lajmerimi i keqpërdorimeve - lidhjeve ilegale.

**5.17.** Me qëllim të përmirimit të inkasimit, të gjithë inkasantet kanë të drejtë të kërkojnë ndihmën e ekipës së çkyqjes, pasë zbatimit të procedurave ligjore për çkyqje.

**5.18.** Menaxhmenti i kompanisë, në rastë nevojë mundë të bëjë edhe ndrrimin e zonave të inkasantëve.

#### **KREU IV.**

##### **Hyrja në fuqi**

###### **Neni 6.**

Kjo rregullore, e rregullon Bazën e të ardhurave për inkasant – sipas relizimit dhe është anex i “Sistematizimit të punëve dhe detyrave të punës” në KRU “RADONIQI” SH.A. Gjakovë.

###### **Neni 7.**

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit dhe do të aplikohet nga data 01.01.2012 dhe e njëjta do të vlen deri me aprovimin e rregullores tjetër.

###### **Neni 8.**

Kjo Rregullore e çfuqizon Rregulloren nr. 53 dt. 07.07.2011.

UD Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

---

## ARSYETIM

Pasi që me “**Rregulloren mbi Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e punëve dhe detyrave të punës**” për Sektorin e shitjes – Inkasant baza e të ardhurave llogaritet sipas realizimit, atëherë jemi të obliguar si Kompani që në bazë të Biznes Planit për vitin 2012, të hartojmë Vendimin “**MBI LLOGARITJEN E TË ARDHURAVE PËRSONALE PËR KATEGORINË E PUNËTORËVE – INKASANT**”, duke bërë organizimin dhe duke propozuar metodologjinë më të mirë të inkasimit të hyrave sipas leximit real mujor të ujmatsëve të konsumatorve për ujin e pijes të shpenzuar, duke bërë faturimin real mujor për konsumatorët për ujin e shpenzuar dhe duke shpërnda e inkasuar faturat mujore 100% nga konsumatorët për ujin e shpenzuar.

Spektori i shitjes – si teresi, sidomos Inkasantet me organizimin dhe përmbushjen e punëve dhe detyrave të punës – inkasimit, janë barometri që matë performancën - suksesin e gjithëmbarshtëm të punëve dhe detyrave të punës të kryera nga të gjithë të punësuarit në Kompani - të të gjithë Departamenteve, Sektorve dhe Shërbimeve të Kompanisë.

Prandaj rrespektimi i kësaj rregulloreje që sot po propozojmë, përveç që rregullon drejtë menyren e llogaritjes e të ardhurave përsonale për kategorinë e punëtorëve INKASANT, jepë edhe një përgjegjësi dhe obligim Ligjor, që Spektori i shitjes si tërësi – nga Udhëheqësi i Spektorit, Ndhimesi i inkasimit dhe Inkasantet, duhet ti përmbushë punët dhe detyrat e punës të planifikuara me Biznes Plan 2012 dhe sipas kësaj rregullore në masën 100%.

Përgjegjësiya dhe obligimi Ligjor bjenë edhe të gjithë të punësuarit tjerë në Kompani - të të gjithë Departamenteve, Sektorve dhe Shërbimeve të Kompanisë, duhet ti përmbushë punët dhe detyrat e punës të planifikuara me Biznes Plan 2012 në masën 100%, sepse kjo është baza e arri9tjes së suksesit.

**Uji pijës është mallë që shërben qytetarve – konsumator për tërë jetën. Ky mallë për tu prodhuar ka një kosto - shpenzim, kjo kosto – shpenzim duhet mbuluar nga të hyrat vetanake të cilat vinë nga shitja e tij si produkt i gatshëm konsumatorve që e përdorin dhe shpenzojnë.**

Kompanija ka obligim Ligjor që gjithë konsumatorve të kyqur në rrjetin e Ujësllsit të ju siguroi ujin e pijës dhe atë përherë në çdo kohë në sasi të mjaftushme dhe me cilësi të lartë perdoruese sipas standardeve të lejuara.

Kompanija ka të drejtë Ligjore që nga konsumatorët e kyqur në rrjetin e ujësllsit të cilët shpenzojnë ujin e pijës, të kerkoi pagesën e faturave mujore për vitin 2012 për sasin e shpenzuar dhe atë në masën 100%.

Kompanija ka të drejtë Ligjore që në vitin 2012 nga konsumatorët të kerkoi edhe Borgjet e pa paguara të faturave për sasin e ujit të pijës të shpenzuar, të grumbulluara me salldo-gjendjen 31.12.2011, duke propozuar dhe mundësuar konsumatorve metodat me të mira për pagesë, qoftë 100% të shumës së borxhit apo duke bërë ri-programimin e borgjit që konsumatorët të paguajnë për periudhen deri 36 muaj në kiste dhe këtë për çdo muaj së bashku me faturen e çdo muaji të vitit 2012, 2013 dhe 2014, dhe këtë sipas MARRAVESHJES që Kompanija do të bënë me konsumatorët, të cilën duhet të përmbahen dy palët 100%.

Kerkojme nga Sektori i shitjes – Udheheqesi I saje, qe me bashkepuntoret e tij ne afatin prej 30 ditesh te sigurojnë:

1. Te propozojne numrin e perafert te konsumatorve te ujit te pijes, për secilin inkasant sipas terenit – listen konkrete, qe inkasantet te barazohen për kryerje edhe te puneve dhe te detyrave sipas pershkrimit që kanë,
2. Te propozojnë organizimit e sektorit, ne puntoret qe do te bëjne leximin e ujematesve te konsumatorve për ujin e pijës të shpenzuar (ne baze te cilit lexim behen faturat) dhe te puntoreve inkasant qe bejne inkasimin e faturave 100% nga konsumatori për ujin e shpenzuar.